



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1203 Prot.

Tiranë, më 7 10 2019

VENDIM Nr. 221, datë 2.10.2019

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", Neni 48 dhe VKM Nr. 786, datë 26.12.2018 "Për miratimin e zonave arkeologjike "A" dhe "B", të qytetit të Durrësit dhe të Planit për Ruajtjen, Mbrojtjen dhe Administrimin e tyre" Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.11, datë 2.10.2019, pasi shqyrtoi kërkesën për miratim të projektit "Godinë banimi 2-3 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë garazh" rruga "17 Janari", zonë arkeologjike "B" Durrës-subjekti "DESLA" sh.p.k., dhe konceptin e realizimit të sondazhit për zonën ku zhvillohet projekti, paraqitur nga subjekt i licencuar në arkeologji. Z. Luan Përzhita.

VENDOSI:

1. Të miratojë konceptin e realizimit të sondazhit për zonën ku zhvillohet projekti, paraqitur nga subjekt i licencuar në arkeologji. Z. Luan Përzhita.
2. Subjekti "DESLA"sh.p.k. duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të realizojë sondazhin arkeologjik, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt. Raporti i tij do të paraqitet në KKA e radhës.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr.384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Investitori "DESLA"sh.p.k., si dhe subjekti i licencuar në arkeologji, i cili do të kryejë sondazhin arkeologjik, në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", Rregullores "Mbi kriteret e ushtrimit të profesionit të arkeologut" (i ndryshuar) dhe akt-marrëveshjes tre palëshe të sipërcituar, janë të detyruar të marrin të gjitha masat për sigurimin dhe ruajtjen e kantierit, si dhe ruajtjen e strukturave arkeologjike, të cilat mund të zbulohen gjatë kryerjes së sondazhit, deri në vendimmarrjen përfundimtare të KKA, në lidhje me to.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al